

VENDIM
Nr. 37, datë 19.3.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Asim Vokshi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Farisia Idrizaj, në datën 19.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 7 (P) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Pren Ranxha, Lumnije Ranxha, përfaqësuar nga avokat Arsen Baltëza, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Endri Ranxha, në mungesë.

Sonila Ranxha, në mungesë.

Fatjon Ranxha, në mungesë.

Shoqëria "Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group" sh.a., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-4767, datë 20.11.2024, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "i" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim kërkesën e kërkuësve Pren dhe Lumnije Ranxha (*kërkuesit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e saj sipas objektit, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të tjera të interesuara, Endri Ranxhës, Sonila Ranxhës, Fatjon Ranxhës dhe shoqërisë "Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group" sh.a. (*shoqëria e sigurimit*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 9.7.2011 ka ndodhur një aksident rrugor, si rezultat i shkeljes të rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesi i mjetit K.A., si rrjedhojë e të cilit ka pësuar dëmtime trupore kërkuesi Pren Ranxha. Mjeti me të cilin është kryer aksidenti ka qenë i siguruar për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, sipas ligjit nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” (ligji nr. 10076/2009), pranë shoqërisë së sigurimit.

2. Në datën 1.12.2011, bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 10076/2009, kërkuesi Pren Ranxha i është drejtuar shoqërisë së sigurimit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti rrugor i datës 9.7.2011, e cila ka vendosur shpërblimin e kërkuesit në shumën 375 700 lekë për dëmin shëndetësor me paafësi të përkohshme.

3. Në datën 23.7.2012 kërkuesit dhe tre fëmijët e tyre, subjektet e interesuara Endri, Sonila dhe Fatjon Ranxha, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për shpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, si rezultat i dëmit shëndetësor të pësuar në aksident, duke pretenduar: kërkuesi Pren Ranxha 5 136 728 lekë, si dhe interesat bankarë për këtë vlerë në masën 586 358 lekë, ndërsa kërkuesja Lumnije Ranxha dhe subjektet e interesuara Endri, Sonila dhe Fatjon Ranxha solidarisht 5 294 920 lekë, si dhe interesin bankar për këtë vlerë në masën 604 416 lekë, si dhe interesat bankarë deri në ekzekutimin e vendimit. Me vendimin nr. 5500, datë 5.5.2014, gjykata e shkallës së parë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, duke detyruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë kërkuesin Pren Ranxha në shumën 4 460 458 lekë, interesat në shumën 509 162 lekë, si dhe interesat deri në ekzekutim të vendimit, ndërsa kërkuesen Lumnije Ranxha dhe subjektet e interesuara Endri, Sonila dhe Fatjon Ranxha në shumën 5 294 920 lekë, interesat në shumën në 604 416 lekë, si dhe interesat deri në ekzekutim të vendimit. Kundër vendimit ka paraqitur ankim shoqëria e sigurimit.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 850, datë 14.4.2016, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit, duke e detyruar shoqërinë e sigurimit të dëmshpërblejë paditësin Pren Ranxha për dëmin pasuror dhe dëmin jopasuror në shumën 1 556 782 lekë, si dhe kamatëvonesat përkatëse për periudhën nga data 7.3.2012 deri në momentin e përmbushjes së detyrimit, ndërsa kërkuesen Lumnije Ranxha dhe subjektet e interesuara Endri, Sonila dhe Fatjon Ranxha për dëmin jopasuror në shumën 183 333 lekë, si dhe kamatëvonesat përkatëse.

5. Për rekursin e kërkuesve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-4767, datë 20.11.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se nuk ekzistonin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), të cilat e bënin të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit.

6. Në datën 15.5.2025, përmes shërbimit postar, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili është regjistruar në Gjykatë në datën 19.5.2025. Në datën 12.6.2025 Mbledhja e Gjyqtarëve ka pranuar kërkesën për dorëheqje të një gjyqtari kushtetues, ndërsa Kolegji i Gjykatës në datën 18.6.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykata e apelit nuk i ka trajtuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në gjykim, sikurse është ai për ligjin e zbatueshëm dhe fuqinë juridike të rregullores nr. 53, datë 25.6.2009 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (*rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së*). Edhe Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka vlerësuar

shkaqet e rekursit të tyre, megjithëse ato përmbushnin kërkesat e nenit 472 të KPC-së në kohën e paraqitjes së tij.

7.2. *Së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuësve në rekurs, në veçanti atij për zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykata e apelit lidhur me pazbatueshmërinë dhe zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, si dhe për moszbatimin nga ajo gjykatë të dispozitave të Kodit Civil (KC) e vendimit unifikues nr. 12, datë 14.9.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 12/2007*). Kolegji Civil i saj nuk ka pranuar kërkesën e tyre për shtyrjen e gjykimit deri në arsyetimin e vendimit të Gjykatës që kishte pranuar ankimin kushtetues individual në një çështje tjetër të ngjashme.

7.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka trajtuar pretendimet dhe argumentet në rekursin e kërkuësve, por vetëm ato të palës së paditur, të cilat kishin marrë përgjigje nga gjykata e apelit.

7.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kryer vlerësim ligjor si gjykatë ligji për pretendimet në rekurs të kërkuësve, ndërsa vendimi i saj është tërësisht i paarsyetuar dhe i mungon analiza juridiko-ligjore, duke mos garantuar kështu zhvillimin e një gjykimi të bazuar në dispozitat ligjore.

7.5. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë zbatuar me efekt prapaveprues rregulloren nr. 53/2009 të AMF-së, e cila nuk ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja. Sipas nenit 117 të Kushtetutës, efektet e këtij akti fillonin pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare dhe jo pas publikimit në faqen zyrtare të AMF-së. Për më tepër, ky akt nënligjor ka dalë në kundërshtim me nenin 118, pika 2, të Kushtetutës, pasi ligji i posaçëm nr. 10076/2009 ka autorizuar AMF-në vetëm për nxjerrjen e rregullave për trajtimin e dëmeve, por jo për të përcaktuar masën e dëmit dhe vlerën e tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Në këtë këndvështrim, kërkuësit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe kanë interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuësit i janë drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi kanë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ata nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion

për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 20.11.2024 dhe është njoftuar në adresën elektronike të përfaqësuesit të tyre në datën 15.1.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 15.5.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

12. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vëren se, pavarësisht se në objektin e kërkesës kërkuesit kanë kundërshtuar vetëm vendimin e Gjykatës së Lartë, në përmbajtje ata kanë ngritur pretendime edhe për vendimin e gjykatës së apelit, duke pretenduar se këto vendime u kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt në drejtim të *së drejtës së aksesit, së drejtës për gjykim nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, sikundër edhe *parimit të sigurisë juridike*, pretendime këto që janë me natyrë kushtetuese.

13. Për sa i përket përmbajtjes dhe natyrës së këtyre pretendimeve, Gjykata vë në dukje se, në thelb, argumentet e kërkuesve parashtrihen në drejtim të qëndrimit të Gjykatës së Lartë për pretendimet e ngritura prej tyre në rekurs, konkretisht identifikimin e ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete dhe zbatimin e tij në çështjen e tyre. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve, të cilat parashtrihen në drejtim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si dhe pozicionin e funksionin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, në ushtrimin e të cilit ajo kontrollon jo vetëm mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta, por edhe respektimin e standardeve kushtetuese për proces të rregullt, për shkak të natyrës subsidiare të kontrollit kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë çështjen në vijim në drejtim të *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit*. Konkretisht, Gjykata do të analizojë nëse në vendimin për mospranimin e rekursit kërkuesit kanë marrë përgjigje përfundimtare nga Gjykata e Lartë për pretendimet e tyre, në garantim të së drejtës së aksesit në atë gjykatë dhe standardit kushtetues të arsytimit të vendimit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Kërkuesit kanë pretenduar se edhe pse në rekurs kanë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material nga gjykata e apelit, për sa i takon pazbatueshmërisë dhe zbatimit me fuqi prapavepruese të rregullores nr. 53/2009, si dhe moszbatimit nga ajo gjykatë të dispozitave të KC-së dhe të vendimit unifikues nr. 12/2007, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje, duke mos e arsyetuar vendimin e saj.

15. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar, po ashtu, se në rastet kur kërkuesi nuk merr përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm standardi i arsytimit të vendimit, por edhe e drejta e aksesit, si dhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 23, datë 25.4.2023; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, në rastin konkret Gjykata do të verifikojë: nëse Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të subsidiaritetit, i ka kthyer përgjigje pretendimit me natyrë kushtetuese të kërkuësve të parashtruar në rekurs lidhur me ligjin e zbatueshëm në llogaritjen e shpërblimit të dëmit të pësuar në aksidentin me mjete motorike; nëse gjykata e apelit ka identifikuar ligjin e zbatueshëm pa gabime ligjore të dukshme; nëse vendimi i mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë është arsyetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë në përputhje me standardet kushtetuese.

19. Gjykata vëren se kërkuësit e kanë nisur procesin gjyqësor për shpërblimin e dëmit nga aksidenti, duke ngritur si gjatë gjykimit në shkallë të parë (në aktin procedural “pretendime përfundimtare”), gjatë gjykimit në apel (kundërshtime në lidhje me ankimin) ashtu edhe në rekurs pretendimin për moszbatimin e rregullores nr. 53/2009, me argumentin se në momentin e ndodhjes së aksidentit ky akt nuk kishte hyrë në fuqi. Lidhur me këtë, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se aksidenti ka ndodhur në datën 9.7.2011, kohë në të cilën ishte në fuqi ligji i posaçëm nr. 10076/2009, i cili gjente zbatim dhe në rastin konkret. Ndërsa për pjesën që nuk rregullohej nga ky ligj gjenin zbatim dispozitat e KC-së, sipas interpretimit të bërë atyre në vendimin unifikues nr. 12/2007 të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, sipas kësaj gjykate, dëmi pasuror dhe jopasuror do të llogaritej sipas këtij legjislacioni, ndërsa sipas nenit 117 të Kushtetutës, rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së, e dalë në zbatim të ligjit të posaçëm dhe e hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletoren Zyrtare nr. 180, datë 25.12.2012, nuk gjente zbatim, pasi në momentin e aksidentit nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare (*shih faqet 9–10 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

20. Gjykata e Apelit Tiranë ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se përlllogaritja e dëmit që rrjedh nga rasti i sigurimit u referohet kërkesave të ligjit nr. 10076/2009 dhe rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, si akte në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit. Sipas kësaj gjykate, rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së, pavarësisht se ishte miratuar dhe botuar pas momentit të ndodhjes së aksidentit rrugor, në nenin 51 të saj parashikonte se zbatohet me efekt prapaveprues nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm. Mbi këtë bazë, duke zbatuar përcaktimet e bëra në këtë rregullore, gjykata e apelit ka ulur masën e

dëmshpërblimit të akorduar në favor të kërkuësve nga gjykata e shkallës së parë (*shih faqen 11 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

21. Ndonëse kërkuësit dhe paditësit e tjerë (fëmijët e tyre) kanë kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit dhe në rekurs kanë ngritur pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material në lidhje me pazbatueshmërinë dhe zbatimin me fuqi prapavepruese të rregullores nr. 53/2009 të AMF-së, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka respektuar normat procedurale dhe se nuk konstatoheshin shkelje që çonin në pavlefshmërinë e procedurës ose të dhënies së vendimit gjyqësor. Sipas kësaj gjykate, palëve u ishte dhënë mundësia të realizonin të drejtën e mbrojtjes, të paraqisnin prova, të njiheshin me provat e palës kundërshtare dhe të shprehnin qëndrimin e tyre për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke u zbatuar të gjitha parimet bazë të procesit të rregullt ligjor. Po kështu, sipas atij kolegji, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngrinte çështje të vlerësimit të provave dilte jashtë juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

22. Në analizë të vendimmarrjeve të mësipërme, Gjykata konstaton se kërkuësit e kanë ngritur në rekurs pretendimin se gjykata e apelit ka identifikuar gabim ligjin e zbatueshëm, duke caktuar për pasojë një vlerë më të ulët dëmshpërblimi nga ajo e gjykatës së shkallës së parë. Sipas tyre, rregullorja nr. 53/2009 nuk ishte e zbatueshme në këndvështrim të nenit 117 të Kushtetutës, pasi mosmarrëveshja kishte lindur ditën e aksidentit, më 9.7.2011, ndërsa rregullorja ishte botuar më vonë në Fletoren Zyrtare. Gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për sa i përket ligjit material të zbatueshëm për llogaritjen e masës së dëmshpërblimit. Kështu, gjykata e shkallës së parë arsyeton se ligji i zbatueshëm përcaktohet nga data e aksidentit, duke vënë në dukje se në fuqi ishte ligji i posaçëm nr. 10076/2009, i cili gjente zbatim edhe në rastin konkret, dhe për pjesën që nuk rregullohej nga ky ligj gjenin zbatim dispozitat e KC-së, sipas interpretimit të bërë atyre në vendimin unifikues nr. 12/2007 të Gjykatës së Lartë. Ndërsa rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së nuk gjente zbatim, sipas nenit 117 të Kushtetutës, pasi në momentin e aksidentit nuk ishte botuar në Fletoren Zyrtare. Kurse gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se, si ligj i zbatueshëm, krahas ligjit të posaçëm nr. 10076/2009, ishte edhe rregullorja nr. 53/2009 e AMF-së, e cila, pavarësisht se ishte miratuar dhe botuar pas momentit të ndodhjes së aksidentit rrugor, parashikonte në nenin 51 të saj se zbatohet me efekt prapaveprues nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm. Këto pretendime, në thelb, kanë të bëjnë me cenimin e parimeve e sigurisë juridike dhe të hierarkisë së akteve në drejtim të aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të cilat kanë natyrë kushtetuese. Megjithatë, Gjykata e Lartë, bazuar në nenet 472 dhe 480 të KPC-së, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetim të kufizuar, pa mbajtur qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkuësve për natyrën e rregullores dhe fuqinë juridike të saj.

23. Ndërkohë situata e vlerësimit të ndryshëm ligjor të çështjes kërkonte që Gjykata e Lartë të ushtronte rolin e saj si gjykatë e ligjit për të verifikuar identifikimin e ligjit të zbatueshëm dhe fuqinë juridike të tij nën dritën e parimit të sigurisë juridike, sipas të cilit individ duhet të marrë dijeni rregullisht për aktet ligjore të cilat duhet të jenë të parashikueshme për efektet e tyre dhe mjaftueshmërisht të qarta. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar lidhur me natyrën juridike të rregullores, nëse ajo kishte natyrë normative dhe, si e tillë, e kishte lidhur fuqinë juridike me botimin në Fletoren zyrtare ose jo. Në varësi të konkluzionit që do të dilte nga kjo analizë, Gjykata e Lartë do të evidentonte se cili duhet të ishte momenti kur ajo hynte në fuqi dhe fillonte të sillte pasoja juridike, nëse rregullorja hynte në fuqi me botimin në faqen zyrtare të AMF-së ose në momentin e botimit në Fletoren Zyrtare. Po ashtu, kjo analizë do të evidentonte edhe qëllimin e nenit 51 të rregullores që parashikonte efektin prapaveprues nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit të posaçëm, duke lehtësuar edhe zbatimin e saj në praktikë për subjektet të

cilave u drejtohej. Në këtë mënyrë edhe kërkuesit mund të aksesoin, të merrnin dijeni dhe rrjedhimisht të parashikonin efektet e rregullores, me qëllim që ata të ishin mjaftueshmërisht të qartë për masën e dëmshpërblimit që u takonte si pasojë e aksidentit të ndodhur.

24. Gjykata ka vënë në dukje edhe më parë se në rastet e shpërblimit të dëmit nga aksidentet, çështjet e veprimit të ligjit në kohë ose të vendosjes respektive hierarkike të normave në konflikt, hyjnë në sferën e kompetencës së gjykatave të zakonshme. Dyshimet në lidhje me veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme, bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si edhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike (*shih vendimet nr. 30, datë 2.5.2025; nr. 82, datë 26.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Po kështu, Gjykata risjell në vëmendje se vetëm një vendim i arsyetuar i jep asaj mundësinë të vlerësojë nëse gjykatat e zakonshme kanë marrë në shqyrtim pretendimet kryesore të palëve dhe mënyrën sesi i kanë trajtuar ato. Veçanërisht kur bëhet fjalë për pretendime me natyrë kushtetuese, në kuadër të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, mungesa e arsytimit të Gjykatës së Lartë e vë në vështirësi/pamundësi Gjykatën për të vlerësuar nëse ajo i ka marrë në shqyrtim dhe nëse i ka vlerësuar ato pretendime (*shih vendimet nr. 30, datë 2.5.2025; nr. 82, datë 26.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj, duhej të kishte mbajtur një qëndrim të shprehur në drejtim të ligjit të zbatueshëm, në përputhje edhe me parimet kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate, ashtu edhe në drejtim të bazueshmërisë në themel të shkaqeve të rekursit që kishin të bënin me aspekte kushtetuese të procesit gjyqësor. Kjo me qëllim që kërkuesit të merrnin një përgjigje për sa i takon zbatueshmërisë së ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes së tyre objekt shqyrtimi. Në këto kushte, në kuadër të rrethanave të rastit konkret, mospranimi i rekursit të kërkuesve nga Gjykata e Lartë, duke u mjaftuar vetëm me parashtrimin në vendim të shkaqeve të rekursit dhe me arsytimin *de plano* se këto shkaqe nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji, pa u dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese, çon në përfundimin se zbatimi i ligjit nga ajo është haptazi i paarsyeshëm dhe vë në dyshim të drejtën e procesit të rregullt ligjor në aspektin e aksesit të lidhur edhe me standardin arsytimit të vendimit gjyqësor.

27. Në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata e Lartë është i bazuar, ndaj ky vendim duhet të shfuqizohet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim.¹

C. Për shpenzimet e përfaqësimit në Gjykatën Kushtetuese

28. Në datën 17.3.2026, përpara shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, kërkuesi Pren Raxha i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, me objekt mbulimin e shpenzimeve në lidhje me çështjen objekt të këtij gjykimi kushtetues. Për këtë qëllim është paraqitur akti, fatura e datës 24.2.2026, i lëshuar nga avokati Arsen Baltëza, në vlerën 200.000 lekë (pa TVSH), i përshkruar si pagesë për përfaqësim gjyqësor.

¹ Gjyqtarja Fiona Papajorgji është shprehur kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, me të njëjtat argumente të shprehura në vendimin nr. 30, datë 2.5.2025, të Gjykatës dhe mendimin e saj të pakicës bashkëlidhur vendimit nr. 82, datë 26.11.2024, po të Gjykatës.

29. Gjykata vëren se në nenin 28 të Ligjit Organik të Gjykatës janë parashikuar rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifën gjyqësore (pika 1); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (pika 2). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (pika 2); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 4). Gjykata vëren se referuar përmbajtjes së dispozitave si më sipër, së pari, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, së dyti, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Në rastin konkret, kërkesa për shpenzimet gjyqësore është paraqitur përpara zhvillimit të seancës plenare.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në parim çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit kushtetues individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërtetohet se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas udhëzimit të përbashkët nr. 18, datë 5.8.2020, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për miratimin e kriterëve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike detyësore” (udhëzimi nr. 18/2020), shpenzimet për ofrimin e mbrojtjes juridike për përfaqësimin në Gjykatë përcaktohen në vlerat 50.000 lekë dhe 60.000 lekë, ndërsa për shërbime juridike jashtëgjyqësore përcaktohen në vlerat 25.000 lekë (përgatitje kërkesë) dhe 500 deri në 1.500 lekë ora (ofrimi i ndihmës juridike në formën e këshillimit – shih rubrikat I dhe II të shtojcës 1 “Tarifat e shërbimeve juridike të avokatëve të ndihmës juridike”). Nga ana tjetër, kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me: kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka theksuar se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, për sa kohë që në gjykimin kushtetues individi kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit. Kjo logjikë ndiqet nga rregullimet ligjore për kompensimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren të paditur Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (neni 399/4, pika 2, i KPC-së) (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Për sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh parashikimet e udhëzimit nr. 18/2020, aktet e përgatitura nga përfaqësuesi i kërkuesit për përfaqësimin e tij në këtë gjykim kushtetues, natyrën e çështjes konkrete, si dhe numrin e pretendimeve të pranuar, vlerëson se masa e

arsyeshme për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore në Gjykatë është në vlerën 30.000 lekë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe pranohet.

33. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuësve duhet të pranohet, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4767, datë 20.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.
4. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuësit në vlerën 30.000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 19.3.2026.

Shpallur më 20.4.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji (kundër)

Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahim, Sandër Beci, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuësve Pren Ranxha, Lumnije Ranxha, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-4767, datë 20.11.2024, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Shumica vendosi shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate, pasi gjeti cenim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, për shkak se Gjykata e Lartë nuk kishte mbajtur qëndrim të arsyetuar për pretendimin e kërkuësve të parashtruar në rekurs në lidhje me zbatimin e rregullores së AMF-së nr. 53/2009, e cila, sipas tyre, nuk duhej të gjente zbatim, pasi nuk kishte hyrë në fuqi në kohën e ndodhjes së aksidentit.

3. Në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, siç është pranuar në jurisprudencën e Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, jo çdo “gabim” procedural justifikon cenimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Vetëm gabimet procedurale që pasjellin njëkohësisht dëmtimin serioz edhe të një të drejte substanciale mund të pasjellin cenimin e vendimmarrjes së

gjykatave. Cenimi i kërkuesve nga mungesa e arsytimit të detajuar të një kërkimi të tyre, për të cilin Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim konstant në jurisprudencën e saj, nuk paraqitet i një rëndësie të tillë që të përbëjë shkak për shfuqizimin si antikushtetues të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë. Pala kishte mundësi të dinte jurisprudencën konstante të Kolegjit Civil, i cili, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit që analizonte se rregullorja e AMF-së nr. 53/2009 ishte e zbatueshme, e ka bërë të vetin atë arsyetim, duke i dhënë kësioj indirekt përgjigje pretendimeve të palës kërkuese. Kjo palë, nga ana tjetër, ishte e detyruar që konform nenit 472 të KPC-së të identifikonte raste të praktikës njësuere ose zhvilluese të praktikës së Kolegjit Civil, që mbështesnin pretendimet e veta në rekurs, në mënyrë që gjykata të shprehej në mënyrë të detajuar (çka nuk rezulton të jetë bërë bindshëm prej tyre).

4. Gjykata, në vendimin e saj nr. 94, datë 17.7.2022, ndër të tjera, afirmon, se: *“Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se dyshimet për veprimin në kohë të normave juridike duhet të zgjidhen nga gjykatat e zakonshme bazuar në parashikimet kushtetuese që përcaktojnë momentin e hyrjes në fuqi të tyre (neni 117 i Kushtetutës), si dhe bazuar në parimin kushtetues të hierarkisë së akteve ligjore (nenet 4 dhe 116 të Kushtetutës), nga të cilat burojnë edhe parimet ku bazohen gjykatat për përcaktimin e ligjit e zbatueshëm në rast të përplasjeve mes normave me fuqi të njëjtë ose të ndryshme juridike.”*. Citimi i nenit 117 të Kushtetutës në fakt u jep përgjigje dhe pretendimeve me natyrë kushtetuese të kërkuesve dhe duhej të çonte gjykatën në rrëzimin e kërimit të tyre.

5. Në vlerësimin tim si gjyqtar në pakicë, çështja kushtetuese paraqitet më e lehtë për t'u zgjidhur nëse mbahen parasysh përcaktimet e nenit 117 pika 1 të Kushtetutës, neneve 3, pika 26, 10 dhe 58 të ligjit nr. 10076/2009 dhe sidomos nenit 3 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar (ligji nr. 9572/2006), sipas të cilit AMF-ja është person juridik, publik, me qendër në Tiranë, i cili është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të përcaktuara në këtë ligj ose në legjislacionin në fuqi dhe nuk lejohet ndërhyrja në veprimtarinë e tij, që mund të cenojë pavarësinë e autoritetit. Dukshëm në këtë rast AMF-ja nuk klasifikohet brenda konceptit kushtetues të “institucioneve të tjera qendrore”, për të cilat flet paragrafi i parë i nenit 117 të Kushtetutës. Ndaj, për hyrjen në fuqi të akteve nënligjore të këtij personi juridik publik të pavarur, nuk është parakusht botimi i tyre në Fletoren Zyrtare. Sipas nenit 117 pika 2 të Kushtetutës shpallja dhe botimi i akteve normative nënligjore të AMF-së bëhet sipas parashikimeve ligjore.

6. Rregullorja e AMF-së nr. 53/2009 duke qenë se sipas nenit 1 pika 2 të saj, u drejtohet vetëm shoqërive të sigurimit, Byrosë Shqiptare të Sigurimit, vlerësuesve të dëmeve në sigurime dhe strukturave të specializuara për trajtimin e dëmeve dhe jo publikut të gjerë, nuk kërkon botimin e saj në Fletoren Zyrtare. Pikërisht, për këtë arsye, në nenin 51, pika 3 të rregullores së AMF-së nr. 53/2009 parashikohet, se: *“Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit të saj në faqen elektronike zyrtare të Autoritetit.”*. Sipas nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative të vitit 1999: *“1. Botimi i akteve administrative është i detyrueshëm vetëm kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji.”*. Ndërsa sipas dispozitave të ligjit nr. 10076/2009 dhe ligjit nr. 9572/2006, pikërisht sepse AMF-ja nuk është institucion qendror i administratës publike, aktet nënligjore të miratuara prej saj, të cilat u drejtohen profesionistëve, nuk kërkohet shprehimisht nga ligjet sektoriale që të botohen në Fletoren Zyrtare për efekt të hyrjes së tyre në fuqi.

7. Kushtetuta në nenin 145, pika 1 të saj detyron gjyqtarët që në zgjidhjen e çështjeve t'i nënshtrohen gjithnjë vetëm Kushtetutës dhe ligjeve, e në rast se ndonjë akt nënligjor bie ndesh me ligjin ose me Kushtetutën, ato e zgjidhin çështjen duke zbatuar drejtpërdrejt këto të fundit. Rregullorja e AMF-së nr. 53/2009 nuk është detyruese për gjykatat, por ato kanë të drejtë ta mbajnë atë parasysh, nëse binden se zbatimi i saj sjell zgjidhjen e drejtë të çështjes. Fakti që Kolegji Civil në rastin konkret nuk ka gjetur problematika të zbatimit të ligjit në lidhje me masën

e shpërblimit (të cilën kërkesit e duan më të lartë), nuk prodhon mosmarrëveshje kushtetuese për sa kohë që dëmshpërblimi që ata kanë marrë është bazuar në kritere objektive e që zbatohen njësoj për të gjithë e mbi të gjitha që nuk bien ndesh me ligjin. Ndaj, në këtë rast, nuk shihet e arsyeshme që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të mblidhet e t'i japë përgjigje çdo pretendimi të palës kërkuese, për sa kohë që pretendimet e saj lidhen me çështje fakti, domethënë me masën e shpërblimit, për të cilën nuk ka ngritur argumente bindëse, për ta trajtuar atë si çështje të mirëfilltë ligji, për shkak të caktimit të vlerave nga gjykata e apelit, në kundërshtim me kriteret ligjore. Fakti që nëse zbatohet vendimi unifikues nr. 12 i Gjykatës së Lartë i vitit 2007 *(i cili nuk zbatohet në këtë fushë për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri nr. 10076/2009 dhe rregullores së AMF-së nr. 53/2009, e cila nuk ka nevojë të botohet në Fletoren Zyrtare)*, kërkesit do të mund të merrnin një shpërblim më të lartë, nuk përbën në vetvete çështje kushtetuese ose ligjore, por çështje fakti që lidhet me vlerësimin e rrethanave të secilës çështje dhe zbatimin e njëlllojtë të metodologjisë së vlerësimit për të gjitha palët. Detajimet e rregullores së AMF-së nr. 53/2009 zbatohen nga gjykatat vetëm brenda limiteve që parashikon ligji, pasi në të kundërt ato e zgjidhin mosmarrëveshjen bazuar në kriteret dhe kufijtë që vendos ligji, duke anashkaluar rregulloren. Kërkesi nuk kanë argumentuar bindshëm ndonjë çështje kushtetuese në këtë drejtim, ndaj kërkesa e tyre duhej të ishte rrëzuar.

Anëtar: Asim Vokshi